



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.505/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS –Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Franciska Zhitija, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Panda-T shpk me seli në Prishtinë kundër të paditues Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.715/19 të datës 07.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.06.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit Panda-T shpk me seli në Prishtinë, Anullohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.715/19 i datës 07.06.2021, dhe Lënda kthehet te Gjykata Komerciale – Departamenti Fiskal, në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.715/2019 të datës 07.06.2021, është Refuzuar kërkesëpapia e paditësit Panda-T shpk me seli në Prishtinë, dhe është lënë në fuqi aktvendimi 01.3.2.2/261 datës 22.02.2019 i paditues Dogana e Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e autorizuar e paditësit Kosovare Sopi avokate nga Prishtina, për shkak të: shkeljes së dispozitave të Ligjit të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të drejtës materiale, duke propozuar që gjykata e apelit, të aprovoj ankesën si të bazuar, dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.715/19 të datës 07.06.2021, ta Prish, apo çështjen ta kthej ne rivendosje si dhe të anuloj aktvendimin 01.3.2.2/261 datës 22.02.2019.

Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 49 të LKA-së, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se;

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, me vendimin përfundimtar nr. 01.3.2.2/261 datës 22.02.2019, në procedurën administrative të ankesave, ka Refuzuar ankesën e paditësit, dhe ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditues Dogana e Kosovës në Prishtinë.

Paditësi ka ushtruar padi në gjykatë duke inicuar konflikt administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, respektivisht ka kundërshtuar vendimin nr.01.3.2.2/261 datës 22.02.2019, me arsyetimin se vendimi i kundërshtuar me padi është i pa drejtë dhe i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 07.06.2021, në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, vërtetoi gjendjen faktike duke u bazuar në provat e lëndës. Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë referohet në dispozitën e nenit 276 pika (k) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, nenin 9 të Ligjit 04/L-099. Gjykata ka dhënë shpjegimet faktike dhe juridike se paditësi me rastin e deklarimit të mallit për zhdoganim e DUD-ave R-33153, 33162 dhe 33159 datës 01.12.2018, nuk e ka deklaruar saktë mallin lëndor fishekzjarr, ku pas kontrollës fizike të mallit nga zyrtarët doganor është gjetur më tepër mall në sasi prej 8,700kg (neto), 8,264kg (neto) dhe 9,416kg (neto), duke iu shmangur taksave doganore në vlerë prej 20,532.00€, 19,503.04€ dhe 22,221.76€. Pra gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi me rastin e paraqitjes së DUD-ave të lartcekur, nuk ka ofruar dëshmi të nevojshme për zbatimin e procedurave doganore, me rastin e deklarimit të mallit, duke mos deklaruar saktë sasinë e mallit lëndor.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, këtë qëndrim juridik të gjykatës së shkallës së parë, e vlerëson si të pa rregullt dhe të pabazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK).

Në këtë çështje administrative, Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi me rastin e paraqitjes së mallit lëndor me tri Deklaratat Unike Doganore R-33159/01.12.2018, R-33162/01.12.2018, dhe R-33153/01.12.2018 në Zyrën e Brendshme Doganore Hani i Elezit, nuk ka paraqit saktë sasinë e mallit fishekzjarr, duke shkaktuar vepër kundërvajtëse doganore nga neni 276 paragrafi (k) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. Në këtë rast e paditura Dogana e Kosovës – Sektori për kundërvajtje doganore, si organ faktik, nxjerr tri vendime administrative, me të cilat i shqipton paditësit tri gjopa administrative, në lartësinë prej 10.000.00€ gjithsejtë 30,000.00€, si përgjegjës për kryerje të kundërvajtje doganore, me të njëjtën datë 01.12.2018, kur paditësi ka deklaruar mallin lëndor në ZBD Hani i Elezit, me tri Deklarata Doganore. Si rrethanë me ndikim në shqiptimin e lartësisë së gjobës, në maksimumin e lejuar ligjor, në tri vendimet administrative, është shkresa e zyrës ligjore me nr.protokoli 449 datës 18.11.2014-Aneksi lartësia e gjobave

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se paditësi me ankesë drejtuar të paditurës në procedurën administrative të ankesave, ka kërkuar sqarimin e shqiptimit të gjobës maksimale, pa dhënë sqarime se si është e mundur që shkresa e zyrës ligjore të përcaktoj lartësinë e gjobave, e mos ti përcaktoj Ligji. Gjithashtu paditësi pretendon dilemën e mos shqiptimit të një gjobe unike. E paditura në arsyetimin aktvendimit nr.01.3.2.2/261 datës 22.02.2019, nuk shqyrton asnjë nga këto pretendimet e palës paditëse, për çka kjo gjykat konsideron se e paditura ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 134 paragrafi 1 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që parasheh: *krahas kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë gjithashtu vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë.*

Gjithashtu në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata ka konfirmuar vendimet administrative të paditurës, pa u bërë administrimi i provës kryesore që ka ndikuar në shqiptimin e lartësisë maksimale të tri gjobave administrative (shkresa e zyrës ligjore me nr.protokoli 449 datës 18.11.2014-Aneksi lartësia e gjobave), dhe gjithashtu gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë një shpjegim ligjor lidhur me pretendimet ankimore të paditësit arsye e mos shqiptimit të një gjobe unike.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret me të drejt gjykata në konflikt administrativ, ka konfirmuar vendimet e të paditurës sa i përket përgjegjësisë së veprimeve të paditësit, duke nxjerr konstatimin se paditësi ka kryer kundërvajtje doganore nga neni 276 pika (k) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. Mirëpo gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesës nga padia e paditësit (neni 44 par.1 i LKA-së), duke iu shmangur shqyrtimit edhe të pretendimeve ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditësit, në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 07.06.2021, lidhur me paqartësitë e përpilimit të 3 kundërvajtjeve doganore, si janë shqiptuar 3 gjoba në shumë maksimale, e që nga aspekti ligjor nuk mundet pala që të dënohet me 3 gjoba maksimale.

Për arsytet e dhëna më lartë, aktgjykimi i kundërshtuar është dashur të priset, dhe çështja ti kthehet Dhomave të shkallës së parë të Gjykatës Komerciale, në rigjykim, për ti mënjeluar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 183, 184 të LPK-së, që janë të atilla që pengojnë vlersimin e ligjshmëris së aktgjykimit të goditur.

Në ri procedurë gjykata e shkallës së parë, duhet ti shqyrtojë të gjitha të metat e lartcekura nga Kolegji i kësaj gjykate, të shqyrtoj me kujdes dispozitat e legjislacionit në fuqi, neni 84 i Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 32 dhe 33 të Ligjit nr.05/L-087 për Kundërvajtje, sigurimin e provës materiale - (shkresa e zyrës ligjore me nr.protokoli 449 datës 18.11.2014-Aneksi lartësia e gjobave, nga e paditura Dogana e Kosovës), dhe pas ballafaqimit dhe provat që janë nxjerr gjatë procedurës administrative, gjykata e shkallës së parë ka mundësi të vlersoj drejt zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, sa i përket pretendimeve ankimore, bashkimin e çështjeve administrative në një procedurë, dhe shqiptimin e sanksionit unik kur kryesi gjykohet në të njëjtën kohë, për një apo më shumë veprime kundërvajtëse, të njëjta ose të ngjashme.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.505/22 datë 20.06.2023

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha